2. Kur gjatë verifikimit identifikohen rrethana që mund të përbëjnë rrezik për sigurinë kombëtare, Rregullatori kërkon vlerësim nga institucioni kompetent për sigurinë kombëtare, i përcaktuar me ligj.	2. Ako se proverom utvrde okolnosti koje mogu predstavljati rizik po nacionalnu bezbednost, Regulator zahteva procenu institucije nadležne za nacionalnu bezbednost, određene zakonom.	2. Where the verification identifies circumstances that may pose a risk to national security, the Regulator shall request an assessment from the institution competent for national security, as designated by law.
3. Institucioni kompetent e dorëzon vlerësimin e tij brenda afatit që do të	3. Nadležna institucija dostavlja procenu u roku utvrđenom Pravilom o izdavanju dozvola.	3. The competent institution shall submit its assessment within the timeframe that will be determined in the Rule of Permitting.

përcaktohet në Rregullën për dhënien e lejeve. 4. Rregullatori mund ta refuzojë lëshimin e lejes kur, në bazë të dokumentacionit të verifikuar ose vlerësimit të institucionit kompetent, konstatohet një rrezik konkret dhe i bazuar që nuk mund të zbutet përmes kushteve të tjera të lejes. Vendimi arsyetohet siç duhet dhe i nënshtrohet mjeteve juridike të parapara me ligj. 5. Ndërmarrja e pajisur me leje është e detyruar ta njoftojë Rregullatorin për çdo ndryshim të pronësisë përfituese, strukturës së menaxhimit, personave që ushtrojnë kontroll ose ndikim vendimtar mbi ndërmarrjen dhe burimeve kryesore të financimit, në pajtim me afatet dhe procedurat e përcaktuara nga Rregullatori. 6. Lejet mund të përmbajnë kushte që Rregullatori i konsideron të nevojshme për aktivitetet që do të kryhen dhe mund të përfshijnë kushte lidhur me: 6.1. detyrimin për respektimin e metodologjive tarifore, tarifave ose pagesave të tjera të miratuara nga	4. Regulator može odbiti izdavanje dozvole ako se na osnovu proverene dokumentacije ili procene nadležne institucije utvrdi konkretan i obrazložen rizik koji se ne može ublažiti drugim uslovima dozvole. Odluka mora biti valjano obrazložena, a protiv nje se mogu koristiti pravni lekovi predviđeni zakonom. 5. Preduzeće kao nosilac dozvole dužno je da obavesti Regulatora o svim promenama stvarnog vlasništva, upravljačke strukture, licima koja vrše kontrolu nad preduzećem ili imaju odlučujući uticaj na njega, kao i glavnim izvorima finansiranja, u rokovima i po postupku koje utvrdi Regulator. 6. Dozvole mogu sadržati uslove koje Regulator smatra potrebnim za obavljanje delatnosti i mogu obuhvatati uslove koji se odnose na: 6.1. obavezu poštovanja tarifnih metodologija, tarifa ili drugih naknada koje je odobrio Regulator, kada se primenjuju na delatnost obuhvaćenu dozvolom;	4. The Regulator may refuse to issue a permit where, on the basis of verified documentation or the assessment of the competent institution, a specific and substantiated risk is established that cannot be mitigated through other permit conditions. The decision shall be duly reasoned and shall be subject to the legal remedies provided for by law. 5. The undertaking holding a permit shall be obliged to notify the Regulator of any changes in beneficial ownership, management structure, persons exercising control or decisive influence over the undertaking, and principal sources of financing, in accordance with the deadlines and procedures established by the Regulator. 6. Permits may contain such conditions as the Regulator considers necessary for the activities to be undertaken, and may include conditions relating to: 6.1. the obligation to comply with tariff methodologies, tariffs, or other charges approved by Regulator, where applicable to the activity covered by permit;

Rregullatori, kur ato zbatohen për aktivitetin e mbuluar me leje; 6.2. çdo detyrim të shërbimit publik, përfshirë detyrimet për ofrimin e shërbimit universal në pajtim me Ligjin për Energjinë Elektrike; 6.3. cilësinë e shërbimit ose furnizimit; 6.4. shkyçjen e konsumatorëve ose masat e tjera të nevojshme për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në nevojë; 6.5. kërkesat për përgatitjen dhe dorëzimin e informatave kontabël dhe informatave të tjera; 6.6. kërkesat e tjera për raportim; 6.7. ndarjen ose veçimin e aktiviteteve afariste; dhe 6.8. kufizimet në aktivitetet e tjera që mund të kryhen nga ndërmarrja e pajisur me leje.	6.2. sve obaveze pružanja usluga od opšteg interesa, uključujući obaveze pružanja univerzalne usluge u skladu sa Zakonom o električnoj energiji. 6.3. kvalitet usluge ili snabdevanja; 6.4. isključenje potrošača ili druge mere neophodne za zaštitu interesa ugroženih potrošača; 6.5. zahteve za pripremu i dostavljanje računovodstvenih i drugih podataka; 6.6. ostale zahteve za izveštavanje; 6.7. razdvajanje poslovnih delatnosti; i 6.8. ograničenja u pogledu drugih delatnosti kojima se može baviti preduzeće koje poseduje dozvolu.	6.2. any public service obligations, including obligations to provide universal service in line with the Law on Electricity; 6.3. quality of service or supply; 6.4. disconnection of customers or other measures necessary to protect the interests of vulnerable customers; 6.5. requirements for the preparation and submission of accounting and other information; 6.6. other reporting requirements; 6.7. unbundling or separation of business activities; and 6.8. limitations on other activities that may be undertaken by the enterprise that holds a permit.
Neni 36 **Afatet e lejeve** 1. Leja mund të jepet për një periudhë deri në dyzet (40) vjet.	**Član 36** **Rok važenja dozvola** 1. Dozvola se može izdati na period do četrdeset (40) godina.	**Article 36** **Terms of Permits** 1. A permit may be granted for a period of up to forty (40) years.

2. Afati dhe vlefshmëria e lejeve përcaktohen si vijon:	2. Rok važenja dozvola utvrđuje se na sledeći način:	2. The term and validity of the permits shall be fixed as follows:
2.1.për aktivitetet e prodhimit të energjisë në bazë të lëndëve djegëse fosile ose ruajtjes së energjisë elektrike apo gazit, në bazë të jetëgjatësisë së aseteve të përdorura për kryerjen e aktivitetit përkatës, me kohëzgjatje maksimale prej dyzet (40) vjetësh;	2.1. za delatnosti proizvodnje energije, skladištenja električne energije ili skladištenja gasa, prema veku trajanja imovine koja se koristi za obavljanje predmetne delatnosti, a najduže na četrdeset (40) godina;	2.1. for the activities of energy generation based on fossil fuels, or the storage of electricity or the storage of gas, on the basis of the lifespan of the assets used for performing the relevant activity with a maximum length of forty (40) years;
2.2 për aktivitetet e prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme ose ruajtjes së energjisë elektrike apo gazit, në bazë të jetëgjatësisë së aseteve të përdorura për kryerjen e aktivitetit përkatës, me kohëzgjatje maksimale prej tridhjetë (30) vjetësh;	2.2 delatnosti proizvodnje energije, skladištenja električne energije ili skladištenja gasa, prema veku trajanja imovine koja se koristi za obavljanje predmetne delatnosti, a najduže na trideset (30) godina;	2.2 for the activities of energy generation based on renewable energy generation or the storage of electricity or the storage of gas, on the basis of the lifespan of the assets used for performing the relevant activity with a maximum length of thirty (30) years;
2.3. për aktivitetet e organizimit dhe operimit të tregut të energjisë, me kohëzgjatje maksimale prej njëzet e pesë (25) vjetësh;	2.3. za delatnosti organizovanja i upravljanja energetskim tržištem, na osnovu finansijskih okolnosti podnosioca zahteva, a najduže na dvadeset pet (25) godina;	2.3. for the activities organization and operation of energy market, with a maximum length of twenty- five (25) years;
2.4. për aktivitetet e transmisionit ose distribucionit së energjisë, në bazë të jetëgjatësisë së aseteve të përdorura për kryerjen e aktivitetit përkatës, me kohëzgjatje maksimale prej tridhjetë (30) vjetësh;	2.4. za delatnosti prenosa ili distribucije energije, prema veku trajanja imovine koja se koristi za obavljanje predmetne delatnosti, a najduže na trideset (30) godina;	2.4. for the activities of energy transmission or distribution, on the basis of the lifespan of the assets used for performing the relevant activity with a maximum length of thirty (30) years;

2.5. për aktivitetet e furnizimit të garantuar, në bazë të gjendjes financiare të aplikantit, me kohëzgjatje maksimale prej tre (3) vjetësh; dhe	2.5. za delatnost snabdevanja u krajnjoj nuždi, na osnovu finansijskih okolnosti podnosioca zahteva, a najduže na tri (3) godine; i	2.5. for the activities of supply of last resort, on the basis of the applicant's financial circumstances with a maximum length of three (3) years; and
2.6. për aktivitetet e furnizimit me energji elektrike, energji termike ose gaz, në bazë të gjendjes financiare të aplikantit, për pesë (5) vjet.	2.6. za delatnosti snabdevanja električnom energijom, toplotnom energijom ili gasom, na osnovu finansijskih okolnosti podnosioca zahteva, na period od pet (5) godina.	2.6. for the activities of supply of electricity, thermal energy, or gas, or, on the basis of the applicant's financial circumstances, for five (5) years.
2.7. për aktivitetet e tregtimit të energjisë elektrike, për pesë (5) vjet ose për një periudhë më të shkurtër në bazë të gjendjes financiare të aplikantit	2.7. za delatnosti trgovine električnom energijom, na pet (5) godina ili na kraći period na osnovu finansijskih okolnosti podnosioca zahteva	2.7. for the activities of trading of electricity, for five (5) years, or for a shorter period based on the applicant's financial circumstances
3. Kohëzgjatja e çdo lejeje mund të vazhdohet për një periudhë shtesë që nuk e tejkalon periudhën përkatëse të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, me kusht që bartësi i lejes t'i përmbushë të gjitha detyrimet dhe kërkesat sipas lejes dhe të ketë dorëzuar aplikim me shkrim për vazhdim. Aplikimi për vazhdimin e lejes dorëzohet jo më vonë se gjashtë (6) muaj para datës së skadimit të lejes, ndërsa bartësi i lejes që kryen një aktivitet të rregulluar të energjisë ose ka detyrim të ofrojë shërbim publik apo universal është i detyruar ta njoftojë Rregullatorin për synimin për të kërkuar vazhdimin e lejes një (1) vit para datës së skadimit të saj.	3. Rok važenja dozvole može se produžiti za dodatni period koji nije duži od odgovarajućeg perioda utvrđenog u stavu 2. ovog člana, pod uslovom da je nosilac dozvole ispunio sve obaveze i zahteve utvrđene dozvolom i podneo pisani zahtev za njeno produženje. Prijava za produženje dozvole podnosi se najkasnije šest (6) meseci pre isteka njenog roka važenja, dok je nosilac dozvole koji obavlja regulisanu energetsku delatnost ili ima obavezu pružanja javne ili univerzalne usluge dužan da obavesti Regulatora o nameri da zatraži produženje dozvole godinu dana pre isteka njenog roka važenja.	3. The duration of any permit may be extended for an additional period that does not exceed the relevant period of the time specified in paragraph 2 of this Article, provided that the permit holder meets all obligations and requirements under the permit and has submitted a written application for extension. The application for the extension of the permit shall be submitted no later than tsix (6) months prior to the permit expiration date, whereas the Permit holder who performs a regulated energy activity or has an obligation to provide a public or universal service is obliged to notify the Regulator of the intention to request an extension of the

		permit one (1) year prior to the permit expiration date.
Neni 37 **Kufizimet për lloje të caktuara të lejeve** 1. Rregullatori mund të lëshojë vetëm një leje për tërë territorin e Republikës së Kosovës për kryerjen e aktiviteteve të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike ose transmisionit të gazit.	**Član 37** **Ograničenja za određene vrste dozvola** 1.Regulator može izdati samo jednu dozvolu za celu teritoriju Republike Kosovo za obavljanje energetskih aktivnosti prenosa i distribucije električne energije ili prenosa gasa.	**Article 37** **Restrictions on Certain Types of Permits** 1. The Regulator may issue only one permit for the entire territory of the Republic of Kosovo for the performance of the energy activities of transmission and distribution of electricity or transmission of gas.
Neni 38 **Procedura për lëshimin e lejeve** 1.Procedura për pajisjen me leje fillon me dorëzimin e aplikimit te Rregullatori, së bashku me të gjitha dokumentet e kërkuara, në pajtim me Rregullat për dhënien e lejeve të përcaktuara në nenin 43 të këtij ligji. 2. Brenda dyzet e pesë (45) ditëve kalendarike nga dorëzimi i aplikimit të plotë, Rregullatori lëshon lejen ose refuzon lëshimin e saj duke dhënë arsyetimin përkatës, dhe këto vendime publikohen pa vonesë në faqen e internetit të Rregullatorit. 3. Në rast të refuzimit të aplikimit për leje sipas paragrafit 2 të këtij neni, aplikanti ka	**Član 38** **Postupak za izdavanje dozvola** 1. Postupak za dobijanje dozvole pokreće se podnošenjem prijave Regulatoru, uz svu potrebnu dokumentaciju, u skladu sa Pravilima o izdavanju dozvola iz člana 43 ovog zakona. 2. U roku od četrdeset pet (45) kalendarskih dana od dana podnošenja potpunog zahteva, Regulator izdaje dozvolu ili obrazloženom odlukom odbija njeno izdavanje. Ove odluke se bez odlaganja objavljuju na internet stranici Regulatora. 3. U slučaju odbijanja zahteva za izdavanje dozvole u skladu sa stavom 2. ovog člana,	**Article 38** **Procedure for issuing permits** 1. The procedure for obtaining a permit shall commence by submitting an application to the Regulator, supported by all required documents, in accordance with the Rules on Permitting specified in Article 43 of this Law. 2. Within fourty five (45) calendar days of the submission of the complete application, the Regulator shall either issue the permit, or refuse to issue the permit with the justification, and such decisions shall be promptly published on the website of the Regulator. 3. In cases of refusal of the application for a permit pursuant to paragraph 2 of this

të drejtë të aplikojë sërish në pajtim me Rregullën përkatëse për dhënien e lejeve, por nuk mund të dorëzojë aplikim të ri para kalimit të gjashtëdhjetë (60) ditëve kalendarike nga data e nxjerrjes së vendimit për refuzim ose, sipas rastit, nga data e hyrjes në fuqi të vendimit gjyqësor. 4. Rregullatori rezervon të drejtën të mos e lëshojë lejen në rastet kur aplikanti është objekt i një hetimi në vijim në pajtim me këtë ligj.	podnosilac zahteva ima pravo da ponovo podnese zahtev u skladu sa odgovarajućim Pravilima o izdavanju dozvola, ali ne pre isteka šezdeset (60) kalendarskih dana od dana donošenja odluke o odbijanju ili, kada je primenljivo, od dana pravnosnažnosti sudske odluke. 4. Regulator zadržava pravo da odbije izdavanje dozvole u slučajevima kada je podnosilac zahteva predmet tekuće istrage u skladu sa ovim zakonom.	Article, the applicant has the right to re-apply in accordance with the respective Rule on Permitting but may not submit a new application before sixty (60) calendar days from the date the decision for refusal was issued, or, if applicable, from the date of entry into force of the court decision. 4. The Regulator reserves the right to withhold the issuance of a permit, in cases when the applicant is subject to an ongoing investigation in accordnace to this law.
Neni 39 **Arsyet për refuzimin e lëshimit të lejes** 1. Rregullatori refuzon lëshimin e lejes nëse: 1.1. ndërmarrja e energjisë nuk i plotëson kërkesat, kushtet ose kriteret, apo ndonjë rregull të përcaktuar me këtë ligj ose ligjet e veçanta që rregullojnë aktivitetet dhe tregjet e energjisë; 1.2. një ndërmarrje e energjisë tashmë është përzgjedhur dhe pajisur me leje për kryerjen e një aktiviteti për të cilin mund të lëshohet vetëm një leje;	**Član 39** **Razlozi za odbijanje izdavanja dozvole** 1. Regulator odbija izdavanje dozvole ako: 1.1. energetsko preduzeće ne ispunjava zahteve, uslove ili kriterijume, odnosno pravila propisana ovim zakonom ili posebnim zakonima kojima se uređuju energetske delatnosti i tržišta; 1.2. je energetsko preduzeće već izabrano i poseduje dozvolu za obavljanje delatnosti za koju se može izdati samo jedna dozvola;	**Article 39** **Grounds for Refusal to issue a Permit** 1. The Regulator shall refuse to issue a permit if: 1.1. the energy enterprise does not meet the requirements, conditions, or criteria, or any rules established with this law or special laws that regulate the energy activities and markets; 1.2. an energy enterprise has already been selected and holds a permit to conduct an activity for which only one permit can be issued;

1.3. aplikanti dhe/ose pronari i tij përfitues përfundimtar është i regjistruar në një vend jashtë Bashkimit Evropian që nuk e njeh Republikën e Kosovës si shtet të pavarur ose në një vend që u nënshtrohet sanksioneve të vendosura nga Republika e Kosovës, duke përfshirë sanksionet e vendosura nga vendet e tjera ose organizatat ndërkombëtare me të cilat është rreshtuar Republika e Kosovës;dhe	1.3. su podnosilac zahteva i/ili njegov krajnji stvarni vlasnik registrovani u državi izvan Evropske unije koja ne priznaje Republiku Kosovo kao nezavisnu državu ili u državi koja je podložna sankcijama koje je uvela Republika Kosovo, uključujući sankcije koje su uvele druge države ili međunarodne organizacije sa kojima je Republika Kosovo uskladila svoje delovanje;i	1.3 the applicant and/or its Ultimate Beneficial Owner is registered in a country outside the European Union that does not recognize the Republic of Kosovo as an independent state, or in a country subject to sanctions imposed by the Republic of Kosovo, including sanctions imposed by other countries or international organizations with which the Republic of Kosovo has aligned;and
1.4. aplikuesi paraqet rrezik të bazuar ndaj sigurisë kombëtare, siç është konfirmuar nga institucioni kompetent për sigurinë kombëtare.	1.4. Podnosilac zahteva predstavlja osnovanu pretnju po nacionalnu bezbednost, što je potvrdila institucija nadležna za nacionalnu bezbednost.	1.4. the applicant poses a substantiated risk to national security as confirmed by the institution competent for national security.
1.5. Aplikuesi është subjekt i një hetimi në vazhdim, në përputhje me nenin 55, paragrafin 1.3, të këtij ligji.	1.5. Podnosilac zahteva je predmet istrage koja je u toku, u skladu sa članom 55. stav 1.3 ovog zakona.	1.5 the applicant is subject to an ongoing investigation in accordnace to article 55 paragraph 1.3 of this law.
2. Rregullatori siguron që arsyet për refuzimin e lejeve të jenë objektive dhe jodiskriminuese, të shtjellohen siç duhet dhe t'i komunikohen aplikantit me shkrim. Për këto arsye të refuzimit njoftohet Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, për qëllime informimi.	2. Regulator obezbeđuje da razlozi za odbijanje izdavanja dozvole budu objektivni, nediskriminatorni i propisno obrazloženi i da se o njima podnosilac zahteva obavesti pisanim putem. Razlozi za odbijanje dostavljaju se Sekretarijatu Energetske zajednice radi informisanja.	2. The Regulator shall ensure that reasons for refusing permits shall be objective and non-discriminatory, duly elaborated, and shall be communicated to the applicant in writing. The reasons for such refusal shall be notified to the Energy Community Secretariat, for information purposes.

3. Dispozitat e këtij neni zbatohen përshtatshmërisht në procedurën për nxjerrjen e vendimit për regjistrim në Regjistrin e lejeve dhe vendimeve për regjistrimin e tregtarëve dhe furnizuesve të huaj të energjisë elektrike dhe gazit që mund të kryejnë aktivitete të energjisë në Republikën e Kosovës.	3. Odredbe ovog člana shodno se primenjuju u postupku donošenja odluke o upisu u Registar dozvola i odluka o registraciji stranih trgovaca i snabdevača električnom energijom i gasom koji mogu obavljati energetske delatnosti u Republici Kosovo.	3. The provisions of this article shall adequately apply in the procedure for issuance of a decision for registration in the Register of Permits and decisions for registration of foreign traders and suppliers of electricity and gas who can carry out energy activities in the Republic of Kosovo.
Neni 40 **Ndryshimi i lejes** 1.Në pajtim me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në nenin 35 të këtij ligji, leja ndryshohet nga Rregullatori: 1.1. me kërkesë të bartësit të lejes, kur pas lëshimit të lejes kanë lindur arsye të justifikuara për ndryshimin e saj, duke përfshirë çdo ndryshim në veprimtarinë kryesore të bartësit të lejes; dhe 1.2. me iniciativën e vetë Rregullatorit, në rrethanat e përcaktuara në Rregullën për dhënien e lejeve, siç janë nevoja për rritjen e konkurrencës, ndryshimet në ligjet e tjera të zbatueshme, ndryshimet në detyrimet e shërbimit publik, rreziku për sigurinë e furnizimit me energji, sigurinë kombëtare,	**Član 40** **Izmena dozvole** 1. U skladu sa uslovima i kriterijumima utvrđenim u članu 35. ovog zakona, Regulator menja dozvolu: 1.1 na zahtev imaoca dozvole, kada nakon izdavanja dozvole nastanu opravdani razlozi za njenu izmenu, uključujući svaku promenu pretežne delatnosti imaoca dozvole; i 1.2 po službenoj dužnosti, u okolnostima utvrđenim Pravilima o izdavanju dozvola, kao što su potreba za unapređenjem konkurencije, izmene drugih primenljivih zakona, promene obaveza javne usluge, ugrožavanje sigurnosti snabdevanja energijom, nacionalne bezbednosti, života i	**Article 40** **Amendment of Permit** 1.Subject to the conditions and criteria specified in article 35 of this Law, a permit shall be amended by the Regulator: 1.1. at the request of the permit holder, when justified reasons for amendment have emerged after the permit was issued, including any change in the principal business of the permit holder; and 1.2. on the Regulator's own initiative under circumstances defined in the Rule on Permitting, such as the need to enhance competition, changes in other applicable laws, changes in public service obligations, a risk to the security of energy supply, to national security, or to the life and health of

jetën dhe shëndetin e qytetarëve ose mbrojtjen e mjedisit. 2. Në rastin nga nënparagrafi 1.2 i këtij neni, bartësi i lejes lirohet nga pagesa për ndryshimin dhe plotësimin e lejes.	zdravlja građana ili zaštite životne sredine. 2. U slučaju iz podstava 1.2. ovog člana, nosilac dozvole oslobađa se plaćanja naknade za izmenu i dopunu dozvole.	citizens, or the protection of the environment. 2. In case of subparagraph 1.2 of this Article, the permit holder shall be exempted from paying a fee for modifying and amending permits.
Neni 41 **Transferimi i lejes** 1. Leja nuk mund të transferohet, përveç në këto raste: 1.1. kur themelohet një shoqëri e re si rezultat i zbatimit të procedurës së ndarjes ligjore (shthurrjes) ose bashkimit; dhe/ose 1.2. bartësi i lejes kërkon pëlqimin e Rregullatorit nëse ndërmerr veprime që do të rezultonin në shitjen e një përqindjeje të aksioneve që do të ndryshonte fuqinë vendimmarrëse ose në ndryshime të tjera të pronësisë që do të kishin efekt të ngjashëm. Për të gjitha ndryshimet e tjera në strukturën e pronësisë, bartësi i lejes dorëzon njoftim brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga	**Član 41** **Prenos dozvole** 1. Dozvola se ne može preneti, osim u sledećim slučajevima: 1.1. kada se osnuje novo preduzeće kao rezultat sprovođenja postupka pravnog razdvajanja (razdvajanja delatnosti) ili spajanja; i/ili 1.2. nosilac dozvole dužan je da zatraži saglasnost Regulatora ako preduzima radnje koje bi dovele do prodaje određenog procenta akcija ili udela, čime bi se promenila ovlašćenja za donošenje odluka, kao i za druge promene vlasničke strukture koje bi imale slično dejstvo. Za sve ostale promene vlasničke strukture, nosilac dozvole dužan je da dostavi obaveštenje u roku od 15 dana od dana registracije promene vlasništva.	**Article 41** **Transfer of Permit** 1. A permit cannot be transferred, except in the following cases: 1.1. when a new company is established as a result of the implementation of a procedure for the legal separation (unbundling) or merger; and/or 1.2. a permit holder shall request the consent of the Regulator if it takes actions that would result in a sale of percentage of shares that would change decision making power and other changes in ownership that would have a similar effect. For all other changes in the ownership structure, the permit holder shall submit notification, within 15 days upon registration of the ownership change.

regjistrimi i ndryshimit të pronësisë. 2. Në rast të transferimit të lejes sipas paragrafit 1 të këtij neni, bartësi i ri i lejes duhet t'i plotësojë kriteret dhe kushtet e përcaktuara në nenin 35 të këtij ligji.	2. U slučaju prenosa dozvole na osnovu stava 1. ovog člana, novi nosilac dozvole mora ispunjavati kriterijume i uslove iz člana 35. ovog zakona.	2. In case of transfer of permit based on paragraph 1 of this article, the new permit holder must meet the criteria and conditions referred to in article 35 of this law.
Neni 42 **Përfundimi dhe pezullimi i lejes**	**Član 42** **Prekid i suspenzija dozvole**	**Article 42** **Termination and Suspension of Permit**
1. Leja përfundon: 1.1. me skadimin e afatit të saj, duke përfshirë çdo vazhdim të këtij afati; 1.2. me kërkesë të bartësit të lejes; dhe 1.3. me tërheqjen e lejes nga Rregullatori në pajtim me këtë ligj. 2. Rregullatori e tërheq lejen nëse: 2.1. bartësi i lejes nuk i përmbush ose i shkel kushtet apo detyrimet e përcaktuara me leje dhe nuk e korrigjon	1. Dozvola prestaje da važi: 1.1. istekom roka njenog važenja, uključujući i eventualno produženje tog roka; 1.2. na zahtev nosioca dozvole; i 1.3. oduzimanjem dozvole od strane Regulatora, u skladu sa ovim zakonom. 2. Regulator oduzima dozvolu ako: 2.1. nosilac dozvole ne ispunjava ili prekrši uslove ili obaveze utvrđene dozvolom, a ne	1. A permit shall be terminated: 1.1. on the expiration of its term, including any extension to its term; 1.2. at the request of the permit holder; and 1.3. upon withdrawal of the permit by the Regulator in accordance with this Law. 2. The Regulator shall withdraw a permit if: 2.1. the permit holder defaults or violates conditions or obligations determined by the permit and does not

këtë mospërmbushje brenda afatit të caktuar nga Rregullatori;	otkloni takvo neispunjenje ili povredu u roku koji odredi Regulator;	remedy such default by a deadline set by the Regulator;
2.2. veprimtaria e bartësit të lejes përfundon me shpalljen e paaftësisë paguese ose likuidimit, me kusht që kjo dispozitë të mos zbatohet në një proces riorganizimi nën mbikëqyrjen e gjykatës, nëse bartësi i lejes vazhdon veprimtarinë gjatë këtij procesi; dhe	2.2. poslovanje nosioca dozvole prestane usled proglašenja stečaja ili pokretanja likvidacije, s tim da se ova odredba ne primenjuje na sudski nadzirani postupak reorganizacije ako nosilac dozvole nastavi poslovanje tokom tog postupka; i	2.2. the permit holder's operation is terminated by a declaration of insolvency or liquidation, provided, however, that this provision shall not apply to a court-supervised reorganization process if the permit holder continues operations during such process; and
2.3 bartësi i lejes ka paraqitur informata të rreme që janë përdorur si bazë për dhënien e lejes dhe këto informata janë thelbësore për kryerjen e duhur të aktiviteteve të lejuara.	2.3 nosilac dozvole dostavi netačne informacije koje su poslužile kao osnov za izdavanje dozvole, a koje su od suštinskog značaja za pravilno obavljanje dozvoljenih delatnosti.	2.3 the permit holder has presented false information which was used as the basis for granting the permit, and such information is material to the proper conduct of permitted activities.
2.4 nëse është konstatuar se bartësi i lejes paraqet rrezik të bazuar për sigurinë kombëtare, të konfirmuar nga institucioni kompetent për sigurinë kombëtare; dhe	2.4 ako se utvrdi da nosilac dozvole predstavlja osnovan rizik po nacionalnu bezbednost, što potvrđuje institucija nadležna za nacionalnu bezbednost;i	2.4. if they have established that the permit holder poses a substantiated risk to national security as confirmed by the institution competent for national security;and
2.5 në bazë të rezultateve të hetimit sipas nenit 55 nënparagrafi 1.3.	2.5. na osnovu rezultata istrage sprovedene u skladu sa članom 55. stavom 1.3.	2.5. based on the results of investigation in accordance to article 55 paragraph 1.3.
3. Leja mund të përfundojë vetëm nëse Rregullatori konstaton se detyrimet e bartësit të lejes, të cilit i është vendosur detyrimi i shërbimit publik, do të	3. Dozvola se može ukinuti samo ako Regulator utvrdi da će obaveze imaoca dozvole kojem je određena obaveza javne usluge na zadovoljavajući način preuzeti i	3. A permit may be terminated only if the Regulator concludes that the obligations of the permit holder who has been imposed public service obligation, will be

përmbushen në mënyrë të kënaqshme nga një bartës tjetër i lejes, që në rastin e furnizimit nënkupton ekzistencën e një furnizuesi të garantuar. 4. Rregullatori mund ta pezullojë përkohësisht lejen kur ekzistojnë arsye të bazuara për dyshim për shkeljen e kushteve të lejes, ose kur pezullimi është i nevojshëm për mbrojtjen e interesit publik dhe sigurisë së sistemeve të energjisë, kur ndikohet negativisht siguria e furnizimit ose për të siguruar përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi. Në këtë rast, bartësit të lejes i jepet një afat i arsyeshëm, deri në gjashtëdhjetë (60) ditë, për të korrigjuar veprimin ose mosveprimin e tij.	izvršavati drugi nosilac dozvole, što u slučaju snabdevanja podrazumeva postojanje snabdevača u krajnjoj nuždi. 4. Regulator može privremeno suspendovati dozvolu ako postoje opravdani razlozi za sumnju da su prekršeni uslovi iz dozvole ili ako je suspenzija neophodna radi zaštite javnog interesa i bezbednosti energetskih sistema, otklanjanja negativnog uticaja na sigurnost snabdevanja ili obezbeđivanja usklađenosti sa važećim zakonodavstvom. U tom slučaju, nosiocu dozvole ostavlja se primeren rok, koji može trajati najviše šezdeset (60) dana, da otkloni posledice svog činjenja ili nečinjenja.	satisfactorily carried out by another permit holder, which in case of supply means there is a supplier of last resort. 4. The Regulator may temporarily suspend a permit where there are reasonable grounds to suspect a breach of the conditions of the permit, or where the suspension is necessary to protect public interest, the safety of the energy systems, impacts negatively the security of supply or otherwise ensure compliance with applicable legislation. In such case, the permit holder shall be given a reasonable time to remedy its action or lack of action, which shall be up to sixty (60) days
Neni 43 **Rregulla për dhënien e lejeve** 1. Rregullatori harton, miraton dhe publikon Rregullën për dhënien e lejeve, e cila përcakton kriteret e parapara në këtë ligj, si dhe hollësitë për termat, kushtet dhe procedurat e lëshimit, ndryshimit, transferimit, pezullimit ose përfundimit të lejeve, si dhe të drejtat dhe detyrimet që duhet të përfshihen në leje.	**Član 43** **Pravilo o izdavanju dozvola** 1. Regulator izrađuje, usvaja i objavljuje Pravilo o izdavanju dozvola, kojim se bliže uređuju kriterijumi propisani ovim zakonom, uslovi i postupci za izdavanje, izmenu, prenos, suspendovanje i prestanak važenja dozvola, kao i prava i obaveze koje dozvole sadrže.	**Article 43** **Rule on Permitting** 1. The Regulator shall draft, adopt, and publish Rule on Permitting that determines the criteria set forth in this Law, as well as details on the terms, conditions and procedures for issuing, amending, transferring, suspending, or terminating permits as well as the rights and obligations to be included in the permits.
Neni 44	**Član 44**	**Article 44**

Certifikimi	Sertifikacija	Certification
1.Operatori i Sistemit të Transmisionit që është certifikuar se i plotëson kriteret e ndarjes e njofton Rregullatorin për çdo transaksion të planifikuar ose ndryshim të pronësisë së Operatorit të Sistemit të Transmisionit të përcaktuar në Ligjin për Energjinë Elektrike dhe/ose Ligjin për Gazin, i cili kërkon rivlerësimin e përputhshmërisë së tij me kriteret e ndarjes dhe pavarësisë në vendimmarrje të përcaktuara për Operatorët e Sistemit të Transmisionit në Ligjin për Energjinë Elektrike dhe/ose Ligjin për Gazin.	1. Operator prenosnog sistema koji je sertifikovan kao operator koji ispunjava kriterijume razdvajanja obaveštava Regulatora o svakoj planiranoj transakciji ili promeni vlasničke strukture operatora prenosnog sistema iz Zakona o električnoj energiji i/ili Zakona o prirodnom gasu koja zahteva ponovno ocenjivanje njegove usklađenosti sa kriterijumima razdvajanja i nezavisnosti u donošenju odluka, utvrđenim za operatora prenosnog sistema navedenim zakonima.	1.Transmission System Operator that has been certified to fulfill the unbundling criteria shall notify the Regulator of any planned transaction or change of the ownership of the Transmission System Operator declared in the relevant Electricity Law or/and in the Law on Gas, which requires a reassessment of its compliance with the unbundling and decision-making independence criteria set for Transmission System Operators in the Electricity Law or/and in the Law on Gas.
2.Rregullatori monitoron përputhshmërinë e vazhdueshme të Operatorit të Sistemit të Transmisionit me kriteret e ndarjes dhe pavarësisë në vendimmarrje të përcaktuara për Operatorin e Sistemit të Transmisionit. Rregullatori rihap procedurën e certifikimit për të siguruar këtë përputhshmëri:	2. Regulator kontinuirano prati usklađenost operatora prenosnog sistema sa kriterijumima razdvajanja i nezavisnosti u donošenju odluka koji se primenjuju na operatora prenosnog sistema. Regulator ponovo pokreće postupak sertifikacije radi obezbeđivanja te usklađenosti:	2. The Regulator shall monitor the continuous compliance of Transmission System Operator with the unbundling and decision-making independence criteria set for Transmission System Operator. The Regulator shall reopen a certification procedure to ensure such compliance:
2.1. pas njoftimit nga Operatori i Sistemit të Transmisionit sipas paragrafit 1 të këtij neni;	2.1. po prijemu obaveštenja Operatora prenosnog sistema iz stava 1. ovog člana;	2.1. upon notification by the Transmission System Operator pursuant to paragraph 1 of this Article;
2.2. me iniciativën e vet, kur ka dijeni se një ndryshim i planifikuar i të drejtave ose ndikimit mbi pronarët e sistemit të transmisionit apo Operatorin e Sistemit të Transmisionit mund të	2.2. po službenoj dužnosti, kada sazna da bi planirana promena prava ili uticaja na vlasnika prenosnog sistema ili operatora prenosnog sistema mogla dovesti do povrede kriterijuma razdvajanja i	2.2. on its own initiative where there is knowledge that a planned change in rights or influence over transmission system owners or Transmission System Operator may lead to an infringement

çojë në shkeljen e kritereve të ndarjes dhe pavarësisë në vendimmarrje të përcaktuara për Operatorin e Sistemit të Transmisionit, ose kur Rregullatori ka arsye të besojë se një shkelje e tillë mund të ketë ndodhur; ose	nezavisnosti u donošenju odluka utvrđenih za operatora prenosnog sistema ili kada Regulator ima razloga da veruje da je takva povreda nastupila; ili	of the unbundling and decision-making independence criteria set for Transmission System Operator, or in cases where Regulator has reason to believe that such an infringement may have occurred; or
2.3. me kërkesë të arsyetuar të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.	2.3. na obrazloženi zahtev Sekretarijata Energetske zajednice.	2.3. upon a reasoned request from the Energy Community Secretariat.
3. Rregullatori nxjerr vendim paraprak për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmisionit sipas paragrafit 1 të këtij neni, brenda katër (4) muajve nga data e njoftimit nga Operatori i Sistemit të Transmisionit ose nga data e dorëzimit të kësaj kërkese nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Nëse brenda këtij afati nuk merret vendim paraprak, certifikimi konsiderohet i dhënë.	3. Regulator donosi preliminarnu odluku o sertifikaciji operatora prenosnog sistema u skladu sa stavom 1. ovog člana, u roku od četiri (4) meseca od dana prijema obaveštenja operatora prenosnog sistema ili od dana podnošenja odgovarajućeg zahteva Sekretarijata Energetske zajednice. Ukoliko se u ovom roku ne donese preliminarna odluka, smatra se da je sertifikacija odobrena.	3. The Regulator shall issue a preliminary Decision on certification of the Transmission System Operator pursuant to paragraph 1 of this Article, within four (4) months from the date of notification by the Transmission System Operator, or from the date of submission of such request by the Energy Community Secretariat. If no preliminary decision is taken within this period, the certification shall be considered to have been granted.
4. Vendimi merret nga Rregullatori vetëm pas përfundimit të procedurave të përcaktuara në dispozitat e këtij neni.	4. Regulator donosi odluku tek nakon sprovođenja postupaka propisanih ovim članom.	4. The decision shall be taken by the Regulator only upon conclusion of the procedures set in the provisions of this Article.
5. Rregullatori e njofton Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë për vendimin paraprak për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmisionit, së bashku me	5. Regulator obaveštava Sekretarijat Energetske zajednice o preliminarnoj odluci o sertifikaciji operatora prenosnog sistema i dostavlja mu relevantne informacije u vezi sa tom odlukom.	5. The Regulator shall notify the Energy Community Secretariat of the preliminary decision on the certification of the Transmission System Operator, along with

informatat përkatëse që lidhen me vendimin. 6. Brenda dy (2) muajve nga pranimi i mendimit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, Rregullatori miraton vendimin përfundimtar për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmisionit, duke marrë parasysh në masën më të madhe këtë mendim. Vendimi i Rregullatorit dhe mendimi i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë publikohen së bashku. 7. Kur vendimi përfundimtar i Rregullatorit dallon nga mendimi i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, Rregullatori ofron dhe publikon, së bashku me këtë vendim, arsyetimin mbi të cilin bazohet vendimi i tij i ndryshëm dhe e njofton për këtë Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë. 8. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë dhe Rregullatori mund të kërkojnë nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe ndërmarrjet që ushtrojnë funksione të prodhimit ose furnizimit çdo informatë relevante për kryerjen e detyrave sipas këtij neni. 9.Rregullatori dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë mbrojnë	6. U roku od dva (2) meseca od prijema mišljenja Sekretarijata Energetske zajednice, Regulator donosi konačnu odluku o sertifikaciji operatora prenosnog sistema, uzimajući to mišljenje u najvećoj mogućoj meri u obzir. Odluka Regulatora i mišljenje Sekretarijata Energetske zajednice objavljuju se zajedno. 7. Ukoliko konačna odluka Regulatora odstupa od mišljenja Sekretarijata Energetske zajednice, Regulator je dužan da uz tu odluku navede i objavi obrazloženje razloga za odstupanje i da o tome obavesti Sekretarijat Energetske zajednice. 8. Sekretarijat Energetske zajednice i Regulator mogu zahtevati od Operatora prenosnog sistema i preduzeća koja obavljaju proizvodne ili snabdevačke funkcije sve relevantne informacije o obavljanju dužnosti u skladu sa ovim članom. 9. Regulator i Sekretarijat Energetske zajednice štite poverljivost osetljivih poslovnih informacija u postupku sertifikacije.	relevant information related to the Decision. 6. Within two (2) months of receiving an opinion of the Energy Community Secretariat, the Regulator shall adopt its final decision regarding the certification of the Transmission System Operator, taking utmost account of that opinion. The decision of the Regulator and the opinion of the Energy Community Secretariat shall be published together. 7. Where the final Decision of the Regulator diverges from the opinion of the Energy Community Secretariat, the Regulator shall provide and publish together with such Decision the reasoning underlying its diverging Decision and shall inform the Energy Community Secretariat accordingly. 8. The Energy Community Secretariat and the Regulator may request from the Transmission System Operator and enterprises that conduct generation or supply functions any relevant information on the performance of duties according to this article. 9. The Regulator and Energy Community Secretariat shall protect the confidentiality

konfidencialitetin e informatave të ndjeshme afariste gjatë procedurës së certifikimit.		of sensitive business information in the certification procedure.
Neni 45 **Certifikimi në raport me vendet e treta**	**Član 45** **Sertifikacija u odnosu na treće zemlje**	**Article 45** **Certification in relation to third countries**
1. Kur certifikimi kërkohet nga një operator ose pronar i sistemit të transmisionit që kontrollohet nga një ose më shumë persona nga një ose më shumë vende të treta, Rregullatori e njofton Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë. Rregullatori e njofton Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë edhe për rrethanat që mund të çojnë në marrjen e kontrollit mbi një sistem transmisionit ose Operator të Sistemit të Transmisionit nga një ose më shumë persona nga një ose më shumë vende të treta.	1. Ukoliko zahtev za sertifikaciju podnese operator ili vlasnik prenosnog sistema koji je pod kontrolom jednog ili više lica iz jedne ili više trećih zemalja, Regulator o tome obaveštava Sekretarijat Energetske zajednice. Regulator takođe obaveštava Sekretarijat Energetske zajednice o okolnostima koje bi mogle dovesti do toga da jedno ili više lica iz jedne ili više trećih zemalja stekne kontrolu nad prenosnim sistemom ili operatorom prenosnog sistema.	1. Where certification is requested by a Transmission System Operator or owner, which is controlled by one or more persons from one or more third countries, the Regulator shall notify the Energy Community Secretariat. The Regulator shall also notify the Energy Community Secretariat on circumstances that could lead one or more persons from one or more third countries to gain control over a transmission system or a Transmission System Operator.
2. Operatori i Sistemit të Transmisionit e njofton Rregullatorin për të gjitha rrethanat që mund të çojnë në marrjen e kontrollit mbi një sistem transmisionit ose Operator të Sistemit të Transmisionit nga një ose më shumë persona nga një ose më shumë vende të treta.	2. Operator prenosnog sistema obaveštava Regulatora o svim okolnostima koje bi mogle dovesti do toga da jedno ili više lica iz jedne ili više trećih zemalja stekne kontrolu nad prenosnim sistemom ili operatorom prenosnog sistema.	2. The Transmission System Operator shall notify the Regulator of all circumstances that could lead one or more persons from one or more third countries to gain control over a transmission system or a Transmission System Operator.
3. Procedura e certifikimit në raport me vendet e treta zbatohet sipas kërkesave të nenit 44 të këtij ligji dhe duke marrë	3. Postupak sertifikacije u odnosu na treće zemlje sprovodi se u skladu sa zahtevima	3. The certification procedure in relation to third countries shall be implemented following the requirements of article 44 of

parasysh kërkesat e veçanta të përcaktuara në këtë nen.	iz člana 44. ovog zakona, uzimajući u obzir posebne zahteve propisane ovim članom.	this Law and taking into account specific requirements stipulated in this article.
4. Rregullatori miraton projektvendimin për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmisionit brenda katër (4) muajve nga data e njoftimit të dhënë nga Operatori i Sistemit të Transmisionit. Rregullatori e refuzon këtë certifikim nëse:	4. Regulator usvaja nacrt odluke o sertifikaciji operatora prenosnog sistema u roku od četiri (4) meseca od dana prijema obaveštenja operatora prenosnog sistema. Regulator odbija sertifikaciju ako:	4. The Regulator shall adopt a draft decision on the certification of a Transmission System Operator within four (4) months from the date of the notification given by the Transmission System Operator. The Regulator shall reject such certification if:
4.1. subjekti në fjalë nuk i plotëson kërkesat për ndarjen dhe pavarësinë në vendimmarrje të përcaktuara për Operatorin e Sistemit të Transmisionit në Ligjin për Energjinë Elektrike dhe/ose Ligjin për Gazin Natyror;	4.1. predmetni subjekt ne ispunjava zahteve u pogledu razdvajanja i nezavisnosti operatora prenosnog sistema u donošenju odluka, utvrđene Zakonom o električnoj energiji i/ili Zakonom o prirodnom gasu;	4.1. the entity in question does not fulfill requirements for unbundling and decision-making independence set for Transmission System Operator in the Electricity Law or/and in the Law on Natural Gas;
4.2. dhënia e certifikimit rrezikon sigurinë e furnizimit me energji në Kosovë dhe në Komunitetin e Energjisë. Gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje, Rregullatori merr parasysh:	4.2. odobravanje sertifikata ugrožava bezbednost snabdevanja energijom na Kosovu i u Energetskoj zajednici. Prilikom razmatranja ovog pitanja, Regulator uzima u obzir:	4.2. granting of the certification shall put at risk the security of the energy supply in Kosovo and the Energy Community. In considering this matter, the Regulator shall take into account:
